

# Çertifikatat e depozitave

CD

## BANKA E SHQIPËRISË

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:  
[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Nëse dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë  
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,  
Tel.: +355-(0)4-222152;  
Faks: +355-(0)4-223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:  
[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)  
Tirazhi: 1000 kopje



## ÇFARË JANË ÇERTIFIKATAT E DEPOZITAVE?

CD është shkurtim për “çertifikata depozite”. Çertifikatë depozite është një mjet investimi për paratë tuaja.

Një çertifikatë depozite është një lloj depozite bankare që ofron interesa më të lartë se një llogari bankare e zakonshme. Ju mund të merrni një letër çertifikatë ose mund të hapni një llogari bankare dhe interesat t`ju kalojnë automatikisht aty. Zakonisht CD është një shumëfish i vlerave 50.000 dhe 100.000 lekë.

Çertifikatat e depozitave janë të transferueshme.

Kur ju blini një CD, ju keni investuar një shumë fikse, për një periudhë fikse e cila ndryshon nga 6 muaj, 1 vit, 5 vjet ose më shumë, si këmbim banka ju paguan interesa në intervale të rregullta.

## LLOJET E CD.

- \* Çertifikatë depozite që mundëson opsionin me një kohë për rritje interesi. Kjo lloj çertifikate ju lejon, që në periudhë afatmesme të mund të zgjidhni një interes më të lartë nëse interesat e tregut rriten.
- \* Çertifikatë depozite me rritje të shkallëzuar ose rritje periodike, i lejon klientit të përfitojë interesa sipas kësaj rritjeje.
- \* Çertifikatë depozite e disponueshme, ka një përqindje fikse të interesit por lejon klientin të tërheqë një pjesë të depozitës fillestare pa paguar gjobë.

## ÇFARË INFORMACIONI DUHET TË DINI PARA SE TË APLIKONI.

Cili është interesi dhe si llogaritet ai? Ky është një informacion shumë i rëndësishëm, që ju duhet ta dini para se të vendosni për investimin e parave tuaja.

A ndryshon interesi vjetor që ju përfitoni? Mundohuni të kuptoni kur dhe sa ky interes mund të ndryshojë.

Kur mbaron afati i një CD? Nuk është i rëndësishëm për t`u kuptuar vetëm interesi, por edhe për sa kohë paratë tuaja do të rrinë të bllokuara në bankë.

A do të rinovohet CD automatikisht pas mbarimit të afatit kur ju nuk i tërhiqni paratë? Nëse po, si do të veprohet në këtë rast?

Bankat shpesh automatikisht rinovojnë CD nëse ju nuk tërhiqni lekët dhe ju njoftojnë për këtë veprim.

## PËRDORIMI I CD.

Së pari, duhet të mendoni shumën që do të depozitoni në bankë dhe për sa kohë do t`i mbani ato para të mbyllura. Përgjithësisht, sa më e mëdhe të jetë depozita aq më i lartë është interesi që ju përfitoni.

E rëndësishme është t`i kushtoni kujdes përqindjes së interesit, kriterëve për minimum depozite, datave të maturimit dhe parashikimeve mbi tërheqjet e parakohshme, të cilat janë të ndryshme për banka të ndryshme.

## PËRFITIMET DHE AVANTAZHET.

- \* CD janë një investim me rrezik të ulët. Në fund të mbarimit të afatit mund t`i merrni ato të kthyer në cash pasi është llogaritur dhe interesi që përfitoni.
- \* Ju siguron paratë në një llogari nga disa javë deri në disa vjet. Në kthim, përfitoni një interes më të lartë se llogaria në çeqe apo llogaria e kursimit.

## PENALIZIMET.

Nëse keni nevojë të tërhiqni paratë përpara mbarimit të afatit të CD, do të paguani gjobë. Ndodh që mund të pësoni një humbje prej disa ose të gjithë interesave që keni fituar dhe ndoshta edhe diçka nga shuma që ju keni depozituar.